

**MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM
NDËRMJET
MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS
NË
FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE MUZEVE**

Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, në vijim referuar si "Palët", bien dakord për bashkëpunimin në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve.

Në zbatim të Deklaratës së përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës" nënshkruar në Prizren më datë 11 janar 2014, Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh, objektin e veprimtarisë së palëve,

Të nxitur, nga dëshira për të zgjeruar dhe përmirësuar bashkëpunimin në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore artistike, bazuar në qëllimin e përbashkët dhe me besim të plotë që kjo marrëveshje do të krijojë mundësitë më të mira për institucionet e trashëgimisë kulturore në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës,

Duke marrë në konsideratë, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve,

Duke vlerësuar, rëndësinë e marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy vendeve, palët bien dakord që:

Neni 1

QËLLIMI

Qëllimi i marrëveshjes është të zhvillojë dhe mbështesë bashkëpunimin kulturor mes dy vendeve në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në përputhje me standardet ndërkombëtare, në përpjekje për të ndërtuar dhe nxitur marrëdhënie dhe shkëmbimin të ndërsjelltë.

Neni 2

FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Palët do të inkurajojnë shkëmbime të rregullta të informacionit në takime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me trashëgiminë kulturore materiale dhe jo materiale dhe muzetë.

Palët do të mbështesin vendosjen e nje bashkëpunimi afatgjatë midis institucioneve të specializuara përgjegjëse për konservimin, restaurimin, mbrojtjen dhe promovimin e monumenteve të kulturës dhe trashëgiminë kulturore materiale në përgjithësi.

Palët do të mbështesin iniciativat e institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe organizatave kulturore në territoret e të dy vendeve, që kanë për qëllim njohjen, promovimin, respektimin reciprok të vlerave të trashëgimisë dhe të së kaluarës historike, shpërndarjen e informacionit mes palëve dhe zhvillimin e shkëmbimit të ndërsjelltë.

Palët do të shkëmbejnë eksperiencën në fushën e menaxhimit të muzeve kombëtare e lokale përmes organizimit të vizitave dypalëshe, seminareve të trajnimit në të dy vendet respektive pjesë e kësaj marrëveshje.

Palët do të nxisin shkëmbimin e informacioneve të rastit, për të parandaluar lëvizjen e paligjshme të pasurive/mallrave kulturore si dhe për të mundësuar kthimin e tyre, të lëvizura në mënyrë të paligjshme nga vendi i origjinës, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Palët do të angazhohen për një bashkëpunim të ndërsjellët midis institucioneve të specializuara përgjegjëse për dokumentimin, qarkullimin ndërkombëtar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme duke përfshirë ndarjen e praktikave më të mira për çështjen e mbrojtjes nga trafikimi i paligjshëm i pasurive kulturore.

Palët do të mbështesin pjesëmarrjen e artistëve dhe grupeve në festivale ndërkombëtare folklorike që zhvillohen në vendet respektive, si dhe bashkëpunimin ndërmjet specialistëve në fushën e kulturës popullore dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale si dhe organizimin e ekspozitave të përbashkëta si Ditë të Kulturës Shqiptare me objekte të trashëgimisë kulturore.

Palët do të mbështesin shkëmbimin e përvojave në fushën e arkeologjisë preventive nëpërmjet organizimit të vizitave studimore, punëtorive dhe seminareve të trajnimit të stafëve të institucioneve kombëtare përgjegjëse.

Palët angazhohen të nxisin dhe mbështesin shkëmbimin e përvojave në fushën e menaxhimit e parqeve arkeologjike përmes organizimit të vizitave studimore në Kosovë dhe Shqipëri.

Neni 3

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SHKËMBIM SHFAQJESH

Palët informojnë njëra-tjetrën për afatet e realizimit të këtyre aktiviteteve, nevojat, programet dhe mundësitë e realizimit të tyre.

Format, kohëzgjatja dhe kushtet financiare të shkëmbimit për realizimin e aktiviteteve në fushën e trashëgimisë kulturore do të zbatohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe do të dakordësohen ndërmjet palëve.

Neni 4

ZBATIMI I MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM

Çdo aktivitet i kryer sipas kësaj marrëveshje, nga cilado Palë, do të bëhet në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e brendshme të asaj palë.

Neni 5

NDRYSHMI I MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM

Dispozitat e kësaj marrëveshje mund të ndryshohen me anë të pëlqimit të ndërsjellë me shkrim nga palët nënshkruese.

Neni 6

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi i kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 7

HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar.

Për zgjidhjen e kësaj marrëveshje, njëra nga Palët Nënshkruese njofton palën tjetër me shkrim, të paktën 6 (gjashtë) muaj para.

Nënshkruar në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të dyja tekstet njëjloj të vlefshëm.

**PËR MINISTRINË E KULTURËS TË
REPUBLICËS SË SHQIPËRISË**


**ELVA MARGARITI
MINISTËR**

**PËR MINISTRINË E KULTURËS,
RINISË DHE SPORTIT
TË REPUBLICËS SË KOSOVËS**


**HAJRULLA ÇEKU
MINISTËR**